



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administratës Publike /Ministarstvo za Javne Uprave /
Ministry of Public Administration

DATË/A:	10.04.2018
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	z. Ramush Haradinaj – Kryeministër
CC:	z. Fatmir Limaj – zv Kryeministër z. Mahir Yagcilar – Ministër i Administratës Publike
NGA/OD/FROM:	Sami Hajdaraj – zv Ministër i MAP-se
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport

I nderuar z Kryeministër,

Me poshtë gjeni raportin tre mujor te punës time si zëvendës Ministër i Ministrisë se Administratës Publike

Në periudhën Janar - Mars 2018 kam ndihmuar Ministrin dhe Sekretarin e Përgjithshëm te MAP ne dhënien e Instruksioneve Departamenteve te Ministrisë se Administratës Publike ne funksion te një administrate efikase dhe te paanshme.

Fushe veprimtaria e MAP është e gjere dhe ne konsultim me Ministrin me shume jam fokusuar ne Departamentin e Standardeve dhe Politikave të Inxhinieringut dhe Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare.

Gjate kësaj kohe se bashku me stafin jemi munduar qe te implementojme planin e punës ashtu siç është aprovuar ne Qeveri dhe gjithashtu jemi bazuar ne projektet qe kane qene ne buxhet dhe objektivat e MAP-se.

Nder projektet kryesore qe kemi filluar ti hartojmë janë :

- Projekti- Komisioni i Pavarur për Media --2018
- Projekti- Shkolla profesionale ne Komoran – Drenas 2017
- Projekti- Shkolla fillore ne Fushtice te Epërme – Drenas 2017
- Projekti -Qendra për vlerësim dhe Standarde – Prishtine 2017-2018
- Projekti- Çerdhja për Prizren 2017 -2018
- Projekti -Shkolla e Muzikës dhe Artit - Prizren -2017-2018
- Projekti- Akademia e Drejtësisë – Prishtine 2017-2018
- Projekti -Kampusi Universitar - Mitrovica 2017-2018
- Projekti -Shqyrtimi i konstruksionit ne objektin e MPMS -2018
- Projekti -Mbindërtimin ne objektin e MPMS -2018
- Projekti -Ndërtimi i Impiantit për bllokun urban -2018
- Projekti -Ndërtimi i Impiantit për ndërtesat e MAP -2018

Nga te cilat janë kompletuar:

- Projekti- Komisioni i Pavarur për Media
- Projekti- Shkolla profesionale ne Komoran – Drenas 2017
- Projekti- Shkolla fillore ne Fushtice te Epërme – Drenas 2017
- Projekti- Çerdhja për Prizren 2017 -2018
- Projekti -Shkolla e Muzikës dhe Artit - Prizren -2017-2018
- Projekti -Shqyrtimi i konstruksionit ne objektin e MPMS -2018

Janë hartuar dhe përgatitur për procedura te mëtejme projekte si: Renovimi i xhamave dhe fasadës ne MFSK dhe AKPM; Renovimi i Kulmit ne Agjencinë Kadastrale; Renovimi I kulmit ne Kulla Rilindje NPP ;Renovimi i pllatos ne ndërtesën e Gërmisë; Renovimi Strehës ne MZHE; Riorganizimi i Arkivave ne ndërtesën te ZKM ; Renovimi i bodrumeve dhe arkivave ne ndërtesë te MPJ ;Hapja e bunarëve ne ndërtesat Qeveritare ;Krijimi dhe rregullimi qasajeve për VIP parking dhe Sistemi i ujitjes ne Rilindja

Se bashku me menaxheret e kontratave kemi vizituar ndërtesat ne progres dhe ate si ne vijim :

- Ndërtesa e IKAP-it
- Salla e Edukatës fizike ne Komforen –
- Ndërtimi i shkollës në Llapushnik, Drenas-
- Shkolla e Kishnices Graçanicë-
- Ndërtesat e fakulteteve në Mitrovicë;
- Ndërtimi i objektit te Prokurorisë Themelore ne Gjakovë, faza II-
- Gjykata Themelore ne Gjakovë-
- Gjykata themelore dega ne Novoberde –
- Shkolla fillore 14+2 k ne Magure –
- Shkolla fillore ne Viti- Pozharan –
- Shkolla fillore 9+1k ne Rahovec –
- Shkolla fillore ne Pjetershtice –
- Shkolla fillore 9+1k ne Bajçine-
- Shkolla fillore 5+1k ne Korenice(Ponoshec)–Gjakove-
- Shkolla fillore ne Peje-
- Salla e Edukatës Fizike ne Ratkovc –
- Ndarjet e hapësirave (Arkivave dhe Kontroles) ne përdhesen e Ndërtesës se Qeverise.

Gjithashtu gjate kësaj periudhe i kemi vizituar ndërtesat qeveritare te cilat i menaxhon MAP e qe janë aktualisht menaxhon me 69 ndërtesa duke përfshire hapësira te brendshme 216,393.76 m² dhe hapësira te jashtme 213,553.93m².

Kemi monitoruar punët e mirëmbajtjes dhe janë evidentuar disa probleme ne mirëmbajtje për shkak te vjetërsisë se ndertave te cilat po mundohemi qe ti sanojmë dhe te bëjmë zgjidhje sa me te mire për zyrtaret qe janë te vendosur ne ato ndërtesa .

Gjithashtu ende ka institucione ne objekte me qira dhe për ketë MAP është duke u kujdesur qe sa me shume te krijoje hapësira për zyrtare.

Për ketë ka përgatitur edhe strategjinë se re për akomodim rezidencial të Institucioneve Qeveritare 2018-2020-2025 ku edhe ka filluar me planifikimin e akomodimit te institucioneve/agjencioneve te pavarura ne lokacionin e ndare për IRK-se ne Hajvali .

Kemi zhvilluar takime me përfaqësues të Transmetuesit Publik RTK të cilët kanë kërkuar që parcela 556/5 në sipërfaqe prej 87459 m² të mundësohet për një Projekt afatgjatë për rrialokimin e RTK nga Qendra e Prishtinës në Lagjen Prishtina e Re, në Hajvali .

Gjatë kësaj periudhe kemi filluar me hartimin e pakos legislative për reformat në administratën publike konkretisht Ligjin për paga , Ligjin për zyrtarët publik dhe Ligjin Organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarur e Gjithashtu kemi filluar edhe me procesin e racionalizimit të agjencioneve ku kemi formuar Sekretariatën për racionalizim dhe jemi duke përgatitur koncept dokumentin që do të dërgohet në qeveri që do të paraprijë racionalizimit .

Me respekt.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Administratës Publike – Ministarstvo Drzavnu Upravu–
Ministry of Public Administration

- 1. Zv. Sami Hajdari, (dorëzuar me datë 10.04.18 – 3 faqe)**
- 2. Zv. Bujar Nerjovaj, (dorëzuar me datë 11.05.18 – 3 faqe)**